



NENI 1 EMERTIMI

Sot me date 29 Maj 2024, themelohet nje shoqeri e se drejtes shqiptare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "DP – E MOBILITY" SH.P.K.

NENI 2 SELIA

Shoqeria ka seli ne Tiranë, ne adresen: Bulevardi "Zhan D'ark", Pallati Titan, Nr. 145, Kati i I-re, pasuria nr. 7/69, regjistruar ne volumn 17, faqe 76, Tirane, Shqiperi.

Asamblea e ortakeve mund te themeloje filiale, seli dytesore ose njesi te tjera operative si dhe te transferoje seline e shoqerise ne nje adrese apo qytet tjeter.

Vendbanim i ortakeve, per te gjitha marredheniet me Shoqerine, do te konsiderohet, per te gjitha efektet, ai qe rezulton nga akti i themelimit apo nga njoftimet e mevonshme te ortakeve ne seline e shoqerise; eshte detyre e ortakeve t'i komunikojne shoqerise ndryshimin e vendbanimit te tyre.

NENI 3 OBJEKTI

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- instalimi i shtyllave te karikimit dhe pikave te karikimit per mjetet elektrike;
- Projektimi, ndertimi, realizimi, menaxhimi per llogari te saj apo te te treteve, qiradhenia dhe dhenia me huaperdorje e stacioneve te sherbimit per karikimin e automjeteve elektrike, si dhe mirembajtja dhe asistenca e impianteve qe ndodhen ne keto stacione per sherbimet e karikimit;
- tregtimi me shume dhe pakice i automjeteve elektrike te reja dhe te perdorura;
- dhenia me qira e mjeteve dhe automjeteve elektrike pa shofer;
- studimet e fizibilitetit, planifikimi dhe projektimi per realizimin e infrastrukturës per burimet e energjisë dhe në veçanti ato për karikimin për mjeteve elektrike.
- blerja, shitja ose shkembimi i pasurive te paluajtshme te cdo lloji dhe kategorie si dhe i te drejtave mbi pasurite e paluajtshme;
- ndertimi, rikonstruksioni, restaurimi dhe mirembajtja, nepermjet prokurimit tek pale te tjera ose permes administrimit direkt te ndertesave dhe objekteve te cdo lloji dhe tipi.
- Qiradhenia dhe menaxhimi, per llogarine e saj dhe per llogarine e te treteve, i objekteve civile, tregtare, industriale dhe bujqesore, nenqiraja, menaxhimi dhe administrimi i ketyre pasurive edhe nese jane dhene me qira financiare (leasing);
- aktivitetet e mirembajtjes, kontrollit dhe monitorimit të infrastrukturave të përmendura në pikat e mësipërme që do të kryhen vete ose duke l'a besuar këto aktivite shoqërive të treta që kanë autorizim specifik;
- Ndertimi, shitja dhe instalimi i sistemit te impianteve, pajisjeve dhe pjeseve te impianteve, si dhe shitja me shumice dhe pakice e tyre dhe i materialeve te ndertimit;
- Agjensi turistike udhetimesh, organizimi i guidave turistike, hoteleri, turizem dhe organizim i eventeve ne fushen turistike;
- Shoqeria gjithashtu mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare dhe operacionet me pasuri të paluajtshme që rezultojne te jene te domosdoshme për arritjen e objektivit te veprimtarise se shoqerise, duke përfshirë dhënien e garancive reale ose personale edhe në favor të palëve të treta.



NENI 4 KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë është e papercaktuar përveç rasteve të shpërndarjes apo likuidimit të vendosur nga asambleja e ortakeve.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakeve themelues në vlerën 10.000 EUR (dhjetë mijë euro). Kapitali themeltar është i ndarë ndërmjet ortakeve si më poshtë:

- **Shoqëria DP REAL ESTATE S.r.l.**, shoqëri e së drejtës italiane, me seli në: Via Tirana 1, 35138, Padova (PD), Itali, me numer unik regjistrimi e kod fiskal n. 05541770284, përfaqësuar nga Administratori Z. Della Penna Umberto, që zoteron 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë e cila përfaqëson 1 (një) kuote me vlerë 5.100 Euro (pese mijë e njëqind euro);
- **Z. Armand Gaxha** zoteron 1 (një) kuote me vlerën 2.500 Euro (dymijë e peseqind euro) e cila përfaqëson 25% të kapitalit të shoqërisë;
- **Z. Bledar Paheshti** zoteron 1 (një) kuote me vlerën 2.400 Euro (dymijë e katerqind euro) e cila përfaqëson 24% të kapitalit të shoqërisë;

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblese së ortakeve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

Ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen e kapitalit që do të emetohet nëpërmjet kontributeve të reja, në përpjesëtim me kuotat e zotëruara prej tyre.

Kapitali mund të zvogëlohet në përputhje me dhe në formën e parashikuar nga ligji dhe në rast të zvogëlimit të kapitalit me më shumë se një të tretën për shkak të humbjeve, një kopje e raportit të administratorëve për gjendjen financiare të shoqërisë, me çdo vërejtje apo koment të Organit Mbikëqyrës ose të audituesit, kur është caktuar një i tillë, nëse nuk depozitohet në seli të paktën tetë ditë para mbledhjes së asamblese, do të lexohet dhe diskutohet gjatë Asamblesë së Ortakeve.

Neni 6 FINANCIMET E ORTAKEVE

Ortakët kanë të drejtë të bëjnë derdhje në kapitalin e shoqërisë ose të japin hua me interes ose pa interes, të cilat nuk përbëjnë mbledhje të kursimeve nga publiku në përputhje me dispozitat e ligjit në fushën bankare dhe kredituese. Huatë e dhëna nga ortakët supozohen të jenë pa interes, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në një akt të shkruar.

NENI 7 PJESEMARRJET NË KAPITALIN THEMELTAR, TRANSFERIMI I KUOTAVE

Pjesëmarrjet e ortakeve në kapitalin themeltar përcaktohen në raport të drejtë me kontributet e tyre në kapitalin themeltar.

Te drejtat, përfshirë edhe e drejta e votes, u takojnë ortakeve në mënyrë përpjestimore me pjesëmarrjen që zoteron secili në kapitalin themeltar.

Në rast tjetërsimi të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar, ortakët e tjere gëzojnë të drejtën e parablerjes. Me "tjetërsim" do të kuptohet çdo akt tjetërsimi i kuotave, në kuptimin me të gjere të fjalës, si në pronesi të plote ashtu dhe të pjesëhme, që, në mënyrë direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit të pronesisë mbi kuotat ose të drejtat mbi to.



Ortaku që synon të tjetërsojë, teresisht ose pjesërisht, kuotat e tij në kapitalin themeltar duhet t'i komunikojë ortakeve të tjere nepermjet letrë rekomande, oferten e marre, duke treguar emrin e bleresit të mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e percaktuar dhe mënyrën e pagesës.

Brenda njezete diteve nga marrja e komunikimit të Ofertes, ortaket e interesuar në ushtrimin e së drejtës së parablerjes duhet t'i komunikojnë ortakut që kalon të drejtat mbi kuotat, dëshirën për të ushtruar të drejtën e parablerjes, përpjestimisht me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar dhe sipas kushteve të Ofertes, duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës së kuotave për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakeve të tjere. Është i pavlefshëm çdo komunikim që nuk përmban të gjitha të dhënat e mësipërme.

Në rast se ndonjë nga personat që gëzojnë të drejtën e parablerjes së kuotave, nuk mund ose nuk dëshirojnë ta ushtrorin atë, e drejta e parablerjes që i takon zmadhohet automatikisht dhe përpjestimisht në favor të ortakeve që kanë shprehur interesin për ta ushtruar këto të drejta.

Në rast se janë disa ortake që ushtrorin të drejtën e parablerjes, kuotat do të shpërndahen ndërmjet tyre në përpjestim me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar të shoqërisë. Në rast se në letrën e komunikimit të Ofertes tregohet si bleres i mundshëm një person që është ortak, edhe atij i njihet e drejta e parablerjes, krahas ortakeve të tjere.

E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë pjesëmarrjen e ofruar dhe për çmimin e percaktuar, duke qenë se i tillë është objekti i propozimit të paraqitur nga ortaku ofruar. Në rast se çmimi vlerësohet tepër i lartë nga ndonjëri prej ortakeve që ka shprehur, në afatet dhe mënyrat e mësipërme, dëshirën për të ushtruar parablerjen, çmimi i tjetërsimit do të percaktohet nga palet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet tyre. Në rast se nuk arrihet asnjë marrëveshje, çmimi do të percaktohet nepermjet raportit të ekspertit të emëruar nga palet me marrëveshje ose, në rast mosmarrëveshjeje, të caktuar nga Gjykata kompetente. Në kryerjen e vlerësimeve të tij, eksperti duhet të ketë parasysh situatën pasurore të shoqërisë, të rentabilitetit të saj, të vlerës së pasurive materiale dhe jomateriale që ajo posedon, të pozicionit të saj në treg si dhe të çmimit dhe kushteve të ofruara nga bleresi potencial, nëse ky është me mirëbesim, si dhe çdo rrethanë apo kusht tjetër që merret normalisht në konsideratë për caktimin e vlerës së pjesëmarrjeve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Në rastin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes, nënshkrimi i kontratës së shitjes së kuotave dhe pagesa perkatese duhet të kryhen brenda afateve të percaktuara në propozimin e shitjes së formuluar nga ortaku ofruar.

Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve të mësipërme dhe për teresinë e pjesëmarrjes së ofruar, ortaku ofruar mund t'i transferojë kuotat e veta në favor të bleresit të treguar në komunikimin e Ofertes dhe në kushtet e parashikuara në të brenda gjashtëdhjetë diteve të ardhshme. Në të kundërt, procedura e parablerjes duhet të përsëritet. Në rast tjetërsimi të kuotave në favor të të tjerëve, pa zbatuar dispozitat e parashikuara me sipër, bleresi nuk do të legjitimohet në ushtrimin e të drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do të prodhojë efekte ndaj shoqërisë.

Nëse asnjëri prej ortakeve nuk e ushtron të drejtën e parablerjes në mënyrat e percaktuara, ortaku ofruar mund të nënshkruajë aktin e shitjes së pjesës së tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Pëlqimi i ortakeve mund të mohohet nëse bleresi i propozuar ndodhet në njërin nga kushtet si më poshtë:

- është dënuar për një veprë penale me vendim gjyqësor, edhe nëse nuk ka marrë ende formën e prerë;
- i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, ka fallmentuar, ose është dënuar me një dënim plotësues që sjell ndalimin, edhe të përkohshëm, të së drejtës për të ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese pranë personave juridikë;
- në momentin e transferimit të pjesëmarrjes, nuk merr përsipër detyrimin kundrejt shoqërisë të kryejë shërbimet aksesore për të cilat detyrohej ortaku shitës;
- ushtron, për llogari të vet ose të dikujt tjetër një veprimtari konkurrese me atë të shoqërisë.

Në rast se pëlqimi i ortakeve mohohet gjithsesi, edhe jashtë rasteve të parashikuara më lart, ortaku gëzon të drejtën e largimit nga shoqëria, sipas afateve dhe modaliteteve të parashikuara nga neni 101 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

E drejta e parablerjes nuk ka nevojë të ushtrohet nga ortaket, në rast të transferimit të kuotave ose të një pjesë të tyre në favor të familjarëve.



Neni 8

TRANSFERIMI I KUOTAVE PËR SHKAK TË VDEKJES

Në rast të vdekjes së një ortakut, trashëgimtarët ose legatarët e ortakut që ka ndërruar jetë, mund të bëhen ortakë vetëm me miratimin e ortakëve që janë në jetë, të cilët do të vendosin, me shumicën e kapitalit të shoqërisë, nëse do të lejojnë pasardhësit e ortakut të ndërrojnë pronësinë e kuotes së zotëruar nga i ndjeri, ose nëse do të vazhdojnë me likuidimin në para të kuotes përkatëse. Në këtë rast, shumica e parave për pjesëmarrjen e ortakut të vdekur do të përcaktohet nga palët me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet tyre. Nëse nuk arrihet marrëveshja, shumica e likuidimit të pjesës së ortakut të vdekur do të përcaktohet me raport nga ekspert i caktuar nga palët me marrëveshje të ndërsjellë ose, në rast mosmarrëveshjeje, do të caktohet nga gjykata kompetente.

NENI 9

VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakëve vendos mbi çështjet që i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi çështjet që njëri ose disa prej administratorëve i paraqesin për miratim. Ortaket gezojnë të drejtën të thërrasin asambletë e ortakëve në rastet dhe me shumicën e parashikuara me ligj. Janë në çdo rast në kompetencën e Asamblesë së ortakëve, që vendos me votën e favorshme të ortakëve që përfaqësojnë shumicën prej 51% të kapitalit të shoqërisë, për vendimet që kanë lidhje:

- emerimin, shkarkimin e administratorëve dhe përcaktimin e strukturës së organit administrativ;
- emerimi, shkarkimi dhe zëvendësimi i ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, duke përcaktuar në këtë rast kriteret e likuidimit;
- blerja dhe shitja e pasurive të paluajtshme;
- dhenia e Garancive;
- Përcaktimi i shpërblimeve të Administratorëve;


Janë në çdo rast në kompetencën e Asamblesë së Ortakëve, që vendos me votën e favorshme të ¾ të ortakëve të pranishëm që përfaqësojnë me shumicë gjysmën e kapitalit të shoqërisë, për vendimet që kanë lidhje me:

- miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve;
- ndryshimet e këtij statuti;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- ndryshimin e formës së shoqërisë ose ristrukturimin e saj;
- vendimet në lidhje me shpërndarjen e parakohshme të shoqërisë;

NENI 10

THIRRJA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakëve e thirrur rregullisht përfaqëson bashkësinë e ortakëve dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë statut, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, edhe nëse këta mungojnë ose nuk janë të njejtë mendim. Asambleja e ortakëve thirret me njoftim dërguar ortakëve në vendbanimin e tyre ose në adresën e postës së tyre elektronike dhe i marre prej këtyre të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë. Në njoftimin e thirrjes duhet të tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve në rend të dritës. Në rast mosrespektimi të formaliteteve të mesiperme, asambleja do të konsiderohet e thirrur rregullisht vetëm nëse është e përfaqësuar teresia e kapitalit themeltar dhe asnjë nuk kundërshton diskutimin e çështjeve në rend të dritës. Asambleja drejtohet nga administratori. Drejtuesi i asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmeve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.



Mbledhjet e Asamblese se ortakeve mund te mbahen edhe nepermjet video-konferences ose tele-konferences, me kusht qe te gjitha pjesemarrjesit te mund te identifikohen dhe te dallohen ne cdo moment te lidhjes, dhe t'u lejohet te ndjekin diskutimin, te marrin, dergojne dhe veshgjojne dokumentat, te nderhyjne gojarisht dhe ne kohe reale mbi te gjitha ceshtjet, si dhe te marrin pjese ne votim dhe te vendosin, ne menyre te tille qe te mund te garantohet metoda kolegjiale dhe zbatimi i parimeve te mirebesimit dhe barazise se trajtimit te ortakeve. Ne prani te kushteve te mesiperme, asamblea e ortakeve konsiderohet e mbajtur ne vendin ne te cilin gjendet drejtuesi i saj. Cdo ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe te votes ne asamble ne perpjestim me pjesemarrjen qe zoteron ne kapitalin themeltar. Ortaket mund te perfaqesohen ne asamble nga persona te tjere nepermjet prokure te posaçme. Prokura eshte e vlefshme vetem per asamblene per te cilen leshohet, te identifikuar sipas rendit te dites. Ortaket nuk mund te perfaqesohen nga administratori i shoqerise. Vota duhet te jete e hapur ose gjithsesi te shprehet me modalitete te tilla qe bejne te mundur identifikimin e ortakeve qe nuk jane te te njejtimit mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga asamblea e ortakeve me shumicen e te pranishmeve, mbi propozim te administratorit. Ne rast se nuk parashikohet ndryshe me ligj, pjeset e kapitalit themeltar per te cilat nuk mund te ushtrohet e drejta e votes do te llogariten per efekt te kuorimit te nevojshem per mbledhjen e vlefshme te asamblese. Vendimet e asamblese se ortakeve duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes, te nenshkruar nga drejtuesi. Procesverbalit te asamblese i bashkangjitet lista e pjesemarrjesve dhe njoftimet e thirrjes.

NENI 11

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Asambleja e Ortakeve ka kompetencën të vendosë nëse shoqëria do të drejtohet nga një administrator i vetëm, nga disa Administratore ose nga Keshilli i Administrimit i përbërë nga të paktën 3 (tre) deri në maksimumin prej 5 (pesë) Administratore.

Administrimi i shoqërisë përfshin të drejtat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit të nevojshme për arritjen e realizimit të objektivit të veprimtarisë, i besohet Administratorit të vetëm ose Keshillit të Administrimit. Në rastin e Keshillit të Administrimit, Administratorët janë të detyruar të informojnë Keshillin për veprimet që kryejnë dhe në rast mosmarrëveshjeje vendos Asambleja e Ortakeve.

Administratori i vetëm ose Administratorët (nëse emërohen) qëndrojnë në detyrë për 5 (pesë) vjet, me të drejtë riemërimi, përveç rasteve kur revokohen nga Asambleja e Ortakeve ose japin dorëheqjen. Kushdo që administron shoqërinë është individualisht përgjegjës ndaj Shoqërisë ose palëve të treta për çdo shkelje të Ligjit dhe/ose Statutit të Shoqatës për gabime të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Në rastin e Keshillit të Administrimit, ky emëron nga rradhet e anetareve të tij kryetarin dhe eventualisht një Administrator të deleguar.

Kryetari i Keshillit të Administrimit duhet të mbledhë Keshillin të paktën një herë në tre muaj dhe të informojë vetë Keshillin e Administrimit për ecurinë e Shoqërisë. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Administratoreve, kryetari duhet të thërrasë Asamblesën e Ortakeve të cilit i delegohen vendimet në lidhje me mosmarrëveshjen.

Administratori ose Keshilli i Administrimit mund të shkarkohet në çdo kohë me vendim të Asamblesës së Ortakeve, me votën e favorshme të ortakeve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit themeltar, pa qene e detyrueshem dhenia e arsyeve për shkarkimin. Shkarkimi i Administratoreve pa shkak të arsyeshëm mund të çojë në perfitimin e një kompensimi financiar në favor të tyre.

Në rast të dorëheqjes së Administratorit, Asambleja e Ortakeve, duhet të mbledhet brenda 30 (tridhjetë) diteve, dhe do të emërojë Administratorin e ri, nëse ky vendim nuk është marrë në të njëjtën mbledhje të Asamblese që është bere edhe revokimi i Administratorit.

Me themelimin e shoqërisë, emërohen Administratorët e parë, me një mandat 5-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje:

1. Z. Massimiliano Ghersel – mbajtes i pasaportës nr. YC1488627.

2. Z. Paolo Della Penna – mbajtes i pasaportës nr. YB0476495.



Shoqëria do të administrohet nga dy Administratoret e siperpërmendur, të cilët do të përfaqësojnë shoqërinë me kompetenca të ndara (veçmas njeri-tjetrit).

NENI 12

KOMPETENCAT E ORGANIT TE ADMINISTRIMIT

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që ligji, akti i themelimit dhe statuti ja rezervojnë asamblese së ortakeve.

Administratori gëzon të drejtë dhe fuqi të plota për kryerjen e çdo veprimi dhe/ose akti që vlerëson të dobishëm për realizimin e objektit të shoqërisë, brenda limiteve dhe sipas modalitetëve të përcaktuar nga asambleja e ortakeve.

Përpos asaj çka parashikohet nga ligji, administratori ka detyrën e kryerjes së veprimeve të mëposhtme:

- hartimin e inventarit, të llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, në mbyllje të çdo viti financiar;
- hartimin e projekteve të bashkimit ose ndarjes së shoqërisë;
- të informojë asambletë mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rendesi për shoqërinë;
- të raportojë përpara asamblese së ortakeve mbi faktet që mund të kenë pasoja negative mbi ecurinë apo ekzistencën e shoqërisë;
- të therrë asambletë e ortakeve në rastet e parashikuara me ligj.
- Hapjen dhe mbylljen e Selive dytësore dhe administrative;
- zvogëlimi i kapitalit themeltar në rast të tërheqjes së ortakut;
- Azhurnimin dhe pershtatjen e statutit të shoqërisë në përputhje me dispozitat rregullatore në fuqi;

Administratoret mund të caktojnë avokate si dhe përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose kategori aktesh, duke i dhënë atyre kompetencat përkatëse.

NENI 13

VENDIMET E KESHILLIT TE ADMINISTRIMIT

Kryetari i Keshillit të Administrimit thërret mbledhjen e keshillit të Administrimit, përcakton rendin e ditës, koordinon punën e keshillit dhe siguron që të gjithë Administratorëve t'u ofrohet informacioni i duhur për pikat e rendit të ditës.

Keshilli mbledhet në vendin e shënuar në njoftimin e mbledhjes, në selinë e shoqërisë ose në një adresë tjetër, sa herë që këtë e çmon të nevojshme kryetari apo edhe nga një prej Administratorëve.

Njoftimi do të bëhet të paktën 3 (tre) ditë para mbledhjes me një njoftim që do të dërgohet me faks, telegram ose e-mail. Në raste urgjente, mbledhja mund të thirret me një njoftim përmes faksit, telegramit ose e-mail, me njoftim të paktën njëzet e katër orë përpara.

Keshilli konstituohet në mënyrë të vlefshme me praninë e shumicës së administratorëve në detyrë dhe vendos me votën e favorshme të shumicës absolute të Administratorëve të pranishëm.

Lejohet mundësia që pjesëmarrësit në mbledhjen e Keshillit të administrimit të marrin pjesë në mbledhje, në distancë, nëpërmjet përdorimit të sistemeve të pajisjeve me telekonferencë ose audiovizive.

Në këtë rast, duhet të jete i mundur që të bëhet identifikimi i të gjithë pjesëmarrësve dhe duhet t'i jepet mundësia e secilit pjesëmarrës për të ndërhyrë, për të shprehur mendimin e tyre, për të marrë ose transmetuar të gjithë dokumentacionin, si dhe natyrën kontekstuale të vendimarrjes.

Mbledhja e keshillit të administrimit do të konsiderohet e mabjtur në vendin ku ndodhen kryetari dhe sekretari.

Mbledhjet e Keshillit drejtohen nga presidenti ose nga Administratori më i lartë për nga pozicioni ose moshë.

Vota nuk mund të jepet me përfaqësim.



NENI 14 PERFAQESIMI

Ne rast te keshillit te administrimit, administratori i deleguar ka perfaqesimin e pergjithshem te shoqerise perpara te treteve dhe ne proceset gjyqesore.

Ne rast emerimi te disa administratoreve, perfaqesimi i shoqerise i takon secilit, bashkarisht ose vecmas, sipas percaktimeve te bera ne aktin e emerimit.

Administratorit te vetem, administratoreve ose anetareve te keshillit te Administrimit, i takojne rimbursimi per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyres se tyre, si dhe nje shperblim vjetor i percaktuar nga ortaket ne aktin e emerimit ose ne vendimin perkates.

NENI 15 ORGANI I KONTROLLIT

Shoqeria, permes vendimit te ortakeve, mund te emeroje nje organ kontrolli ose nje auditues ligjor per llogarite duke u percaktuar atyre kompetencat dhe fuqite.

Organi i Kontrollit mund te krijohet nga nje auditues i vetem ose nga nje koleg audituesish te perbere nga tre anetare efektive dhe nga dy zevendesues.

Kur organi i kontrollit ushtron edhe auditimin ligjor te llogarive, te gjitha anetaret e tij duhet te jene te zgjedhur nga rradhet e audituesve ligjore te regjistruar ne regjistrin perkates.

NENI 16 VITI USHTRIMOR DHE BILANCI

Viti ushtrimor mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti.

Ne mbyllje te çdo viti ushtrimor, organi administrativ harton bilancin e vitit ushtrimor, brenda afateve dhe ne perputhje me dispozitat e ligjit. Bilanci mund t'u paraqitet ortakeve per miratim brenda njeqindetetedhete diteve nga mbyllja vitit ushtrimor. Dokumentat e kontabilitetit, te shoqeruara nese e nevojshme nga relacioni i eksperteve kontabel te autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakeve dhe te vihen ne dispozicion te tyre prane selise se shoqerise, te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Pasqyrat financiare duhet te miratohen nga Ortaket brenda 120 (njëqind e njëzete) ditëve nga përfundimi i vitit ushtrimor ose brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nëse këtë e kërkojnë nevoja të veçanta në lidhje me strukturën dhe objektin e shoqërisë; në rastin e fundit, Administratoret duhet të raportojnë arsyet e vonësës në raportin e tyre të administrimit.

NENI 17 FITIMET

Fitimet qe rezultojne nga bilanci ushtrimor do te shperndahen ndermjet ortakeve pasi te jene zbritur nga kjo shume vlera e humbjeve te pesuara gjate vitit ushtrimor paraardhes si dhe 5% (pese per qind) qe destinohet per fondet e rezerves se domosdoshme, derisa kjo te kete arritur kufirin e parashikuar me ligj.

Pjesa qe mbetet pas zbritjes se zerave te mesiperm, do tu shperndahet pronareve te kuotave te kapitalit themeltar perpjestimisht me pjesemarrjet e tyre, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, me perjashtim te destinimit te ndryshem te vendosur nga vete ortaket.

NENI 18 SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE



Shpërndarja e parakohshme e shoqërisë vendoset nga asamblea e ortakeve me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti, në rastet e parashikuara nga ligji:

Në rast se realizohet ndonjëri nga shkaqet që sjell shpërndarjen e shoqërisë, asamblea e ortakeve, me vendim të posaçëm të marrë gjithmone me shumicat e parashikuara për ndryshimin e statutit, do të përcaktojë modalitetet e likuidimit dhe do të emerojë një ose disa likuidatore duke përcaktuar njëkohsisht edhe kompetencat përkatëse. Shoqëria mund të anulohet në çdo moment gjendjen e likuidimit, me vendim të asamblese të marrë me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 19

TERHEQJA E ORTAKUT

Ortaku që nuk ka marrë pjesë në miratimin e vendimeve për ndryshimin e objektit të shoqërisë, transformimin, bashkimin dhe ndarjen e shoqërisë, revokimin e statusit të likuidimit, transferimin e selisë jashtë shtetit, kryerjen e veprimtarisë të cilat përfshijnë një modifikim thelbësor të objektit të shoqërisë ose një modifikim të rëndësishëm të të drejtave që u atribuohen ortakeve.

E drejta e tërheqjes zbatohet në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.

Tërheqja nuk mund të ushtrohet dhe, nëse është ushtruar tashmë, është e paefektshme, nëse shoqëria anulon vendimin që e legjitimon atë, ose nëse mbledhja e ortakeve vendos për shpërbërjen e shoqërisë.

E drejta e ortakut për të ushtruar të drejtën e tërheqjes duhet t'i komunikohet Organit Administrativ me letër rekomande me vërtetim të marrjes brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga regjistrimi në Regjistrin e Shoqërive të vendimit që legjitimon të drejtën e tërheqjes; nëse fakti që legjitimon tërheqjen është i ndryshëm nga vendimi i shkruajtur në Regjistrin e Bizneseve atëherë ushtrohet brenda tridhjetë ditëve nga marrja në dijeni nga ortaku. Kuotat për të cilat ushtrohet e drejta e tërheqjes nuk mund të transferohen.

Kur një ortak ka komunikuar dëshirën e tij për t'u tërhequr në mënyrën e përcaktuar më sipër, drejtorëve u kërkohet të ofrojnë të gjithë pjesën e tij për shitje në emër dhe për llogari të palës që tërhiqet, duke specifikuar çmimin e shitjes dhe afatin e pagesës i barabartë me njëqind e tetëdhjetë ditë. Për shitjen zbatohen rregullat e ushtrimit të së drejtës së parablerjes më sipër.

NENI 20

ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakeve ose ndërmjet ortakeve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 21

LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të disiplinohet nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 22

DISPOZITA FINALE

Ky Statut do të nënshkruhet dhe vërtetohet në origjinal në gjuhën italiane dhe më pas do të përkthehet në gjuhën shqipe dhe italishtja do të jetë gjuha mbizotëruese. Në rast mospërputhjeje midis versionit italisht dhe shqip, ortaket bien dakord të prodhojnë dokumente në gjuhën shqipe që modifikojnë ose ndryshojnë versionin në gjuhën shqipe, kur është e



nevojshme, në mënyrë që të pasqyrohet sa më saktë që të jetë e mundur, versioni i nënshkruar në gjuhën italiane të kësaj. statut .

Ky Statut përfshin edhe Aktin e themelimit të shoqërisë. Ky Statut është hartuar në katër kopje, ne 4 kopje origjinale, e nënshkruar nga ortaket themelues, në prani të përkthyeses së gjuhës italiane znj. Aida Sino.

ORTAKET THEMELUES

PD REAL ESTATE S.r.l.
Përfaqësuar nga:
Z. Della Penna Umberto
(nenshkrimi)

Bledar Paheshti
(nenshkrimi)

Armand Goxha
(nenshkrimi)

Përkthyesi:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU



DATE 31/05/2024
NR REP 4207

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 31/05/2024 para meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

Znj. **Aida Sino**, atësia Arti, amësia Fiqrete, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Thoma Koxhaj 03920267; Nd. 42; H. 12; Ap. 21;Tiranë, lindur më 24/10/1988, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036111917 dhe nr. personal I86024046R, e cila me deklaroi se ka perkthyer dokumentin bashkelidhur nga gjuha Italiane ne gjuhen Shqipe.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"; në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetoj nënshkrimin e përkthyesit.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU



**STATUTO
DELLA SOCIETÀ
"DP - E MOBILITY" sh.p.k.**

**ART. 1
DENOMINAZIONE**

È costituita una società di diritto albanese a responsabilità limitata denominata "DP - E MOBILITY" sh.p.k.

**ART. 2
SEDE LEGALE**

La società ha sede legale a Tirana, all'indirizzo: Bulevardi "Zhan D'Ark", Pallati Titan, Nr. 145, NP 7/69, Kati I, registro catastale vol. 17, fq. 76, Tirana, Albania.

È facoltà dell'Assemblea dei soci istituire filiali, sedi secondarie o altre unità operative ovvero trasferire la sede legale presso un altro indirizzo o Comune.

Il domicilio dei soci, per tutti i rapporti con la Società, si intende a tutti gli effetti quello risultante dall'atto costitutivo o da successive notifiche del socio presso la sede sociale; è onere del socio comunicare il cambiamento del proprio domicilio.

**ART. 3
OGGETTO SOCIALE**

La società ha ad oggetto della sua attività:

- Installazione di colonnine e punti di ricarica per veicoli elettrici,
- la progettazione, la costruzione, la realizzazione, la gestione per conto proprio e/o per terzi, la locazione e/o il comodato d stazione di servizio per la ricarica di autoveicoli elettrici nonché la manutenzione e l'assistenza agli impianti presenti nelle stesse stazioni di servizio di ricarica;
- il commercio all'ingrosso e al dettaglio di autoveicoli e auto elettriche nuove e usate;
- il noleggio senza conducente di autoveicoli e auto elettriche;
- studi di fattibilità, pianificazione e progettazione per la realizzazione delle infrastrutture delle fonti energetiche ed in particolare di quelle per la ricarica per la mobilità elettrica;
